

2012/01

Gjendja e Mediave në Kosovë



Autor: **Shkamb Qavdarbasha**

Redaktor: **Krenar Gashi**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Katalogimi në Publikim (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

659.3(496.51) Qavdarbasha, Shkamb

Gjendja e mediave në Kosovë / Shkamb Qavdarbasha.

Prishtinë : Instituti për Politika Zhvillimore, 2012. - 24 f. ; 30 cm.

ISBN 978-9951-627-00-9



Bashkëpunimi Rajonal
Regional Cooperation



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development



Qeverisja Demokratike
Democratic Governance

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
2. METODOLOGJIA.....	4
3. LEGJISLACIONI DHE RREGULLATORËT.....	5
4. PLURALIZMI MEDIAL.....	8
5. INDIKATORËT NDËRKOMBËTARË PËR MEDIAT NË KOSOVË.....	10
6. SFIDAT E VAZHDUESHME.....	15
6.1 Presioni mbi gazetarë.....	15
6.2 Qasja në informata.....	17
6.3 Gazetaria profesionale dhe menaxhimi.....	18
6.4 Radio Televizioni i Kosovës.....	21
7. PËRFUNDIME.....	22
8. REKOMANDIME.....	23

1. HYRJE

Fusha e mediave në Kosovë iu ka nënshtruar shumë ndryshimeve të mëdha gjatë 12 viteve të fundit, që nga përfundimi i luftës. Nën mbikëqyrjen rregullative të disa institucioneve të ndryshme, sfidat që i kanë ndeshur gazetarët kanë qenë të konsiderueshme. Një pjesë e konsiderueshme e disa sfidave, siç janë krijimi i pluralizmit të subjekteve mediale, sigurimi i një mase të qëndrueshmërisë si dhe adresimi i një numri të çështjeve ligjore tanimë janë tejkaluar. Në anën tjetër, monitorimi tregon në mënyrë të vazhdueshme se më shumë punë duhet të bëhet për krijimin e plotë të normave të shprehjes së lirë, kufizimin e presionit mbi gazetarë dhe të sigurimin e një fushe të gazetarisë profesionale.

Kushtetuta e Kosovës përfshinë provizione për mbrojtjen e fjalës së lirë, qasjen në informacion dhe pluralizmin medial. Këto dispozita kanë çuar në reforma ligjore, siç është krijimi i ligjit për qasje në dokumente publike, dekriminalizimin e shpifjes, mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, etj. Megjithatë, më shumë punë duhet të bëhet për t'u siguruar se politikat që dalin nga ligjet nuk lënë hapësirë për keqinterpretime dhe se ligjet e tanishme janë duke u zbatuar në mënyrën e duhur.

Çështja e ligjeve është vetëm një nga aspektet e problemeve me të cilat ballafaqohen mediat. Raportet ndërkombëtare rreth gazetarisë në Kosovë shpesh kanë qenë të zëshme rreth një numër të problemeve të vazhdueshme që ndikojnë në sferën e medieve në vend. Një nga këto sfida është presioni ndaj gazetarëve. Dhuna dhe kërcënimet e drejtpërdrejta, edhe pse janë të shpërndara në mënyrë alarmante, nuk janë më forma kryesore e presionit ndaj gazetarëve. Me një ekonomi të dobët botërore, presioni financiar është duke u bërë më i dukshëm në media dhe si rrjedhojë tek gazetarët.

Ky problem përkeqësohet duke pasur parasysh që programet akademike për fushën e gazetarisë akoma janë në fazën e konsolidimit në vend. Këto programe gjithashtu kanë hasur në kritika, duke e lënë trajnimin në vendin e punës si forma parësore e avancimit profesional. Shumë programe të trajnimit jo akademik janë zhdukur, duke lënë pak opsione për avancim profesional, me hapësira të mëdha kohore në mes njëra tjetrës dhe kualitet të dyshimtë.

Mediat akoma duhet të ballafaqohen me probleme financiare ndërkohë që reklamat dhe forma të tjera të të hyrave vazhdojnë të zhvillohen. Ky është një problem më i vogël sa i përket mediave transmetuese nacionale, të cilat kanë marrëdhënie më të mira për reklama, kryesisht për shkak të numrit më të madh të shikuesve. Përkundër faktit që ka shikueshmërinë më të lartë, transmetuesi publik ka qenë temë e shumë debateve mbi pengesat ligjore lidhur me financimin e tij përmes Buxhetit të Kosovës dhe janë ngritur pyetjeve për pavarësinë e tij. Zgjidhja e kësaj çështje është pritur të vijë pjesërisht përmes

miratimit të ligjit mbi transmetuesin publik, mirëpo është ende herët për të ardhur me një përfundim.

Me qëllim që të sigurohet liria e plotë e fjalës, qëndrueshmëria e mediave dhe një kualitet më i lartë gazetarisë, duhet të zgjidhen edhe shumë sfida në përgjithësi në fushën e mediave në Kosovë. Për zgjidhjen e këtyre çështjeve nevojitet një konsensus i të gjitha palëve të përfshira, mirëpo edhe ngritja e vetëdijes së publikut. Prandaj, qëllimi i këtij studim është që të analizojë arsyet rreth problemeve më urgjente në sektorin e mediave si dhe të bëjë apel për sugjerime të informuara për mënyrat se si mund të zgjidhen këto çështje.

2. METODOLOGJIA

Përmes këtij raporti, INDEP mëton të identifikojë proceset e politikave që udhëheqin çështjet e përgjithshme dhe të vazhdueshme që kanë ndikim në sektorin e mediave, siç janë identifikuar në raportet ndërkombëtare. Për të bërë këtë, INDEP ka përdorur metoda të shumfishta të hulumtimit gjatë fazës së përpilimit të raportit.

INDEP ka përzgjedhur katër lloje të ndryshme të botimeve të detajuara vjetore ndërkombëtare, të cilat e analizojnë gjendjen e mediave në Kosovë. Raportet janë përzgjedhur në bazë të dominimit, metodologjisë së zhvilluar dhe të vërtetuar të vlerësimit, konsistencës, pavarësisë, donatorëve të ndryshëm dhe profesionalizmit të tyre. Më pas, në këto raporte janë analizuar informatat në vijim: ndonjë apo të gjithë faktorët e notës apo pikëve lidhur me fushën e mediave si dhe të gjitha konkludimet, qofshin pozitive apo negative, lidhur me fushën e mediave për të gjitha vitet kur janë botuar raporte për Kosovën.

INDEP ka përdorur të gjitha notat dhe pikët për të përcaktuar trajektoren e përgjithshme të performancës së sektorit të mediave në Kosovë përgjatë viteve. Të gjitha diagramet e paraqitura në këtë punim janë prodhuar nga INDEP, përveç në rastet e specifikuara ndryshe, duke përdorur të dhënat e organizatave Freedom House, *Nations in Transit*, Reporters Without Borders, *Media Freedom Index*, European Union *Country Progress Reports*, IREX *Media Sustainability Index*.

Çështjet e përbashkëta dhe të vazhdueshme – çdo çështje e cila është identifikuar për tri apo më shumë vite është konsideruar si çështje e vazhdueshme. Çështje të përbashkëta janë konsideruar ato çështje të cilat janë identifikuar në së paku tri nga raportet ndërkombëtare që janë cekur më lartë për tri apo më shumë vite me radhë. Çështjet negative të cilat hynë në të dy kategoritë, mirëpo të cilat janë identifikuar si çështje të cilat janë zgjidhur dhe që nuk janë përsëritur më nuk janë marrë parasysh në analizën e detajuar. Si rezultat i kësaj, INDEP ka ardhur në përfundim se ekzistojnë katër çështje kryesore të cilat përsëriteshin dhe ishin të

përbashkëta në raporte dhe ato janë analizuar në mënyrë të detajuar në fund të këtij punimi. Analiza në vazhdim është një hulumtim kualitativ i cili vlerëson kornizën ligjore, politikën dhe praktikën për të gjitha çështjet. INDEP ka intervistuar edhe pjesëmarrësit kryesorë të mediave, përfshirë këtu edhe kryeredaktorët e subjekteve kryesore mediale, analistë të shquar të mediave, dhe hisedarët ndërkombëtarë në vend. Këto intervista janë bërë për tri arsye kryesore - respektivisht, për të balancuar ndonjë interpretim të njëanshëm, për të siguruar një bazë më të gjerë të opinionit analitik dhe për të kontrolluar faktet.

Analizat që gjenden këtu janë të bazuara në fakte dhe politika të cilat, sipas njohurive më të mira të autorëve gjatë kohës së botimit, ishin korrekte.

3. LEGJISLACIONI DHE RREGULLATORËT

Normat ligjore që i referohen mediave apo aspekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me punën e mediave në Kosovë i janë nënshtruar disa ndryshimeve pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999.

Nën administrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), mediat i nënshtroheshin rregulloreve të ish-Jugosllavisë dhe atyre të UNMIK-ut si dhe ishin nën mbikëqyrjen e Komisionerit të Përkohshëm për Media (KPM), të emëruar ndërkombëtarisht. Megjithatë, këto rregullore nuk ishin të bazuara në normat shoqërore, por në autoritetin e UNMIK-ut, dhe disa prej tyre nuk ishin sipas standardeve perëndimore.¹ Përveç kësaj, analistët konsideronin se UNMIK-u i shihte mediat e Kosovës nga këndvështrimi i paqeruajtës, e jo si një e drejtë themelore.² Kjo perspektivë e ka përforcuar ngurtësinë raportuese dhe ka penguar zhvillimin e përgjithshëm të mediave.

Që nga koha e administratës së UNMIK-ut, Kosova ka miratuar një numër të ligjeve me qëllim që të rregullojë aspekte të caktuara të fushës mediale në vend. Kushtetuta e Kosovës është korniza më e rëndësishme ligjore e cila siguron lirinë e fjalës dhe shprehjes në Kosovë, e cila është miratuar pas shpalljes së Pavarësisë, në vitin 2008. Neni 42 i Kushtetutës së Kosovës siguron pluralizmin medial, ndalon censurën si dhe siguron të drejtën për korrigjimin e informatës jokorrekte, jo complete, ose të pavërtetë për qytetarët, nëse të drejtat e tyre janë shkelur. Dispozitat kushtetuese konsiderohet se janë të përshtatshme, sidomos duke pasur parasysh se nuk përfshihet asnjë nen ose normë tjetër ligjore potencialisht kufizuese.

¹ IREX, Media Sustainability Index Europe & Eurasia (2002), f.45

² IREX, Media Sustainability Index Europe & Eurasia (2004), f.56

Neni 41 i Kushtetutës parasheh të drejtat për qasje në informata publike, përveç nëse janë të klasifikuara në një mënyrë tjetër me ligj. Deri në vitin 2010, mungesa e ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë mund përdorej nga zyrtarët publik si një justifikim për të klasifikuar çdo gjë si konfidenciale me qëllim që informatat të mos bëheshin publike. Megjithatë, pas miratimit të ligjit, kjo praktikë është hequr, ose së paku nuk përdoret më si arsytim.

Neni 41 i Kushtetutës së Kosovës i ka shtruar rrugën Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr. 2010/03-L215, i cili specifikon procedurat dhe kërkesat e nevojshme për qasje në dokumentet publike. Ligji i njëjtë ka ekzistuar edhe gjatë administrimit të UNMIK-ut dhe ishte miratuar pas presionit të ushtruar nga mediat, organizatat jo-qeveritare (OJQ) vendore dhe ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrësit e tjerë. Përkundër normave të përcaktuara në ligjet e cekura më lartë, gazetarët vazhdojnë të ballafaqohen me çështje serioze sa i përket qasjes në informacione publike. Kjo ndodh për shkak të mungesës së përgatitjes së stafit të institucioneve shtetërore dhe mungesës së vullnetit politik për zbatimin e ligjit, çështje e cila do të trajtohet në mënyrë të detajuar në vijim të analizës.

Një nga ligjet më të rëndësishme në vend lidhur me punën e gazetarëve është Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes.³ Problemet rreth këtij ligji kanë qenë të shumta, sidomos kur kemi parasysh se shpifja është trajtuar deri vonë sipas kodit penal si veprë penale. Kjo ka bërë presion të pavend mbi gazetarët dhe ka ngritur pyetje lidhur me nivelin e vet-censurës të shkaktuar nga ky ligj. Megjithatë, ndjekja penale e rasteve të shpifjes nuk është proceduar në shumicën e rasteve.

Në vitin 2007, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) miratoi Ligjin kundër Shpifjes dhe Fyerjes, ligj ky i cili e bëri shpifjen çështje civile. Megjithatë, dispozitat e kodit penal nuk patën ndryshuar, kështu që ka ekzistuar një dyfishim i kodit penal dhe civil derisa një qëndrim parimor i Gjykatës Supreme të Kosovë vendosi në vitin 2012⁴ se shpifja, trillimi dhe fyerja duhet të konsiderohen si vepra civile. Kjo ndoshta ka zvogëluar pak presionin në punën e gazetarëve, duke e ndihmuar fjalën e lirë në vend, së paku nga perspektiva ligjore.

Ekziston frika se sipas ligjit civil, gazetarët mundet të iu nënshtrohen gjobave shumë të larta nga aktpaditë e motivuara politikisht si dhe nga palët tjera imponuese. Kjo çështje potenciale është shtyrë përpara nga perceptimi se gjyqësori në Kosovë është politik, ndikimi i të cilit mund të përdoret për të kontrolluar lirinë e shprehjes.⁵ Kjo ndodh sidomos kur kemi parasysh faktin se sistemi i drejtësisë në Kosovë konsiderohet si lidhja më e dobët e qeverisjes. Edhe pse ende është herët që të arrihet një përfundim i tillë, sipas mendimit të

³ Kuvendi i Kosovës, Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes Nr.02-L65 (2006)

⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, Qëndrim Parimor Nr. K.94/2012 (2012)

⁵ Intervistë e INDEP me Faik Isphiu, Drejtor Ekzekutiv, Internews Kosova. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012

redaktorëve të mediave, një praktikë e tillë është shumë pak mundur si dhe nuk është ndier ndonjë presion përmes kanaleve të tilla.⁶ Disa aktipadi të profilit të lartë ende janë duke pritur në gjykata.

Shpifja si vepër penale është zgjidhur në mënyrë permanente përmes miratimit të Kodit Penal në vitin 2012. Megjithatë, kodi i ri ka problemet e veta. Tani për tani, sa i përket zbulimit të informatave dhe burimeve, gazetarët ende iu nënshtrohen kërkesave ligjore sipas një numri të rrethanave të elaboruara në kodin penal.⁷ Kjo dispozitë ligjore paraqet kërcënime serioze për punën e gazetarëve dhe marrëdhënieve të cilat ata mund t'i ndërtojnë me burimet e tyre, gjë e cila e vështirëson rolin vëzhgues së mediave.

Kosova ka gjithashtu edhe dy institucione që kanë role mbikëqyrëse në fushën e mediave të shkruara dhe transmetuese. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) është themeluar si institucion i Kosovës për të zëvendësuar Komisionerin e Përkohshëm për Media të epokës së UNMIK-ut. Roli i KPM-së është që të menaxhojë brezin e frekuencor të transmetuesve, duke bërë udhëzime për licencimin e transmetuesve, dhënien e licencave, monitorimin lidhur me respektimit e rregullave të licencës dhe caktimit të dënimeve në rastet e shkeljes së licencës. KPM ka për detyrë që të avancojë aspektin teknik edhe etik të transmetimit në Kosovë.

Sidoqoftë, KPM nuk ka qenë në gjendje të përmbushë tërësisht detyrat e veta kryesisht për shkak të mos caktimit të Këshillit të KPM-së, trupi vendimmarrës në këtë institucion. Deri në 2012, KPM ka pranuar nominime nga organizata të shoqërisë civile për anëtar të këshillit, ka përzgjedhur kandidatët më të përshtatshëm të cilët janë rishikuar nga një komision ad-hoc në Kuvend dhe pastaj propozimet finale janë votuar nga Kuvendi. Ky proces është vonuar nga Kuvendi i Kosovës për shkak të rishikimit të ligjit për KPM por gjithashtu për shkaqe të mundshme politike. **8** Pas aprovimit të ligjit të ri për KPM në 2012, e tërë procedura e përzgjedhjes së Këshillit, përveç pranimet të kandidaturave, është përgjegjësi e Kuvendit dhe një komisioni ad-hoc. Ky ligj gjithashtu parasheh një afat kohor ligjor prej 60 ditësh për të zgjedhur Këshillin e ri, një fakt i cili e shtyn akoma më tej përzgjedhjen. Si rezultat, KPM ka qenë e paaftë që të marrë vendime mbi disa çështje serioze, veçanërisht rreth mbikëqyrjes së portaleve të informacionit në internet, përmbushjen e kërkesave ligjore për operatorët kabllor, etj.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është themeluar në vitin 2005 me qëllim që të avancojë kodin e etikës dhe të monitorojë respektimit të këtij kodi, të hartuar nga mediat e shkruara. Këshilli i Mediave të Shkruara është një trup vetë-rregullues që

⁶ Intervistë e INDEP me Astrit Gashi, Kryeredaktor, Zëri. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012


⁷ Kuvendi i Kosovës, Drafti i Kodit Penal (23 prill 2012), Neni 38, Paragrafi 2.

⁸ Intervistë e INDEP me Argjentina Grazhdanin, Eksperte e mediave, korrespondencë me email, Prill 2012.

përbëhet nga Bordi në të cilin përfaqësohen të gjithë anëtarët e këshillit, respektivisht mediat e shkruara. Bordi ka për detyrë të shqyrtojë ankesat dhe parashtresa që i paraqiten Këshillit. Këshilli monitoron mediat e shkruara, mirëpo edhe pranon ankesat nga palët e treta, si dhe shërben edhe si ndërmjetësues në mes të palëve të prekura dhe mediave. Ndryshe nga KPM, KMSHK nuk varet nga fondet e shtetit, dhe është i përcaktuar që të financohet nga anëtarët. Megjithatë, vetëm dy anëtarë të këshillit i kontribuojnë buxhetit, kurse të gjitha aktivitetet tjera mbulohen nga donatorët.⁹ Këshilli i boton të gjitha mendimet mbi ankesat e pranuar për mediat e shkruara që nuk janë anëtare të tij.

4. PLURALIZMI MEDIAL

Edhe sipas standardeve liberale, skena mediale e Kosovës është mjaftë e populluar. Që nga viti 2011, vendi ka 22 televizione, tri prej të cilave janë televizione nacionale, nëntë gazeta dhe 92 radio stacione. Këto shifra kanë qenë mjaftë konsistente që nga përfundimi i luftës në vitin 1999. Nga viti 2008, Kushtetuta e Kosovës e siguron pluralizmin medial në Kosovë. Rritja e një numri kaq të lartë të subjekteve mediale është pjesërisht për shkak të financimit të konsiderueshëm nga donatorët, financim ky i cili i dedikohet krijimit të mediave në kohën e pas-luftës.¹⁰ Financimi nga donatorët ka siguruar që transparenca e mediave të jetë e lartë



⁹ Intervistë e INDEP me Nehat Islamin, Drejtor i Administratës, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012

¹⁰ Ibid. (8)

dhe tregu i mediave të jetë plural dhe jo i monopolizuar. Sidoqoftë, transparenca në mediumet të cilat operojnë në internet me fokus në Kosovë shpesh është e mangët, dhe pronarët nuk janë të ditur.

Pasi që mbështetja e donatorëve për media praktikisht ka përfunduar, është pritur zvogëlimi i numrit të subjekteve mediale, kryesisht për shkak të dilemave rreth qëndrueshmërisë së tyre në kohërat e vështira ekonomike dhe për shkak të tregut të vogël reklamues. Këto dyshime ishin akute sidomos gjatë analizimit të gazetave, radio stacioneve dhe televizioneve lokale për shkak të dominimit të mediave nacionale, siç janë Radio Televizioni i Kosovës, Grupi Koha, Zëri, TV 21 si dhe stacioneve si-motra dhe shkathësive e tyre për të absorbuar pjesën më të madhe të të hyrave nga reklamat. Megjithatë, një dukuri e tillë nuk është vërejtur ende për shkak se numri i subjekteve ka pësuar shumë pak ndryshime përgjatë viteve.

Çështja e subvencionimit mund të shpjegojë pjesërisht elasticitetin e subjekteve mediale – një numër i mediave janë pronë e personave që kanë shumë biznese në sektorë të ndryshëm. Kjo nuk është një çështje e ndër-pronësisë në vete, për shkak se mediat nuk posedohen nga bizneset e tjera, mirëpo bizneset e ndryshme e kanë pronarin e njëjtë. Në këtë kuptim, mediat të cilat janë nën pronësinë e një afaristi mbijetojnë në bazë të subvencioneve, disa nga të cilët kanë agjenda potenciale politike.¹¹ Në anën tjetër, me qëllim që të mbesin në këtë biznes, mediat më të vogla rajonale dhe lokale zbatojnë standarde më konservative të shpenzimeve në shpinë të kualitetit të gazetarisë.

Megjithatë, pronësia e mediave në Kosovë konsiderohet se është transparente. Kjo ndodhë edhe për shkak se vendi është i vogël, e jo për shkak të përpjekjeve të vetëdijshme të mediave për të siguruar transparencë. Kjo është një gjë pozitive sepse e zvogëlon ndikimin që mund ta kenë mediat politike në opinionin publik sepse animet politike e secilit subjekt medial janë të njohura për të gjithë. Faktikisht, disa analistë mendojnë se pas paraqitjes së mediave të qarta politike, pronarët e tyre duhet t'i bëjnë publike animet politike të këtyre subjekteve mediale me qëllim që lexuesit dhe shikuesit të kenë mundësinë për të mbledhur mendime të ndryshme politike.¹² Sidoqoftë, një spektrum medial publikisht i politizuar mund të shkaktojë një fraksionalizim të mëtejshëm të sferës mediale në Kosovë.

Me një pluralizëm dhe transparencë kryesisht të kënaqshme në Kosovë, qytetarëve do të duhej të iu ofrohej një spektër i gjerë dhe i plotë i informatave. Megjithatë, shikueshmëria dhe lexueshmëria më e madhe akoma i përkasin transmetuesve dhe gazetave të mëdha, duke zvogëluar kështu numrin e burimeve të informatave. Me sofistikimin e gazetarisë për fusha specifike, ky trend i medieve do të duhej të ndryshonte. Sidoqoftë, për të arritur atë nivel të zhvillimit duhet të vendosen disa të drejta dhe liri themelore.


¹¹Gashi, K. "Tirazi dhe Politizimi i Mediave të Shkruara në Kosovë", Prishtinë, Kosovë, OSCE – KIPRED, 2009

¹² Intervistë e INDEP me Faik Ispahiu, Drejtor Ekzekutiv, Internew Kosova. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012.

5. INDIKATORËT NDËRKOMBËTARË PËR MEDIAT NË KOSOVË

Gjatë viteve që pasuan rënien e blloqeve komuniste në lindje dhe tranzicionit të tyre në demokraci, një numër i organizatave ndërkombëtare filluan të përpilojnë raporte monitorimi për lirinë e mediave në vendet e dala nga komunizmi. Këto raporte apo tregues u krijuan për të reflektuar lirinë, qëndrueshmërinë, profesionalizmin e mediave si dhe çështje tjera sipas standardeve të pranuar ndërkombëtare për mediat e lira dhe të qëndrueshme, të zhvilluara sipas praktikave më të mira perëndimore. Raporte të njëjta janë hartuar edhe për Kosovën, si një vend që ka dalë edhe nga lufta por edhe nga një regjim autoritar.

Për të bërë vlerësimin e gjendjes në këto vende, raportet kërkojnë përgjigje kualitative dhe kuantitative për një numër të pyetjeve lidhur me sektorin e mediave. Mes tjerash, këto pyetje përfshijnë edhe konsiderata rreth dispozitave ligjore për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e gazetarëve, mungesën e presionit politik dhe institucional ndaj gazetarëve dhe subjekteve mediale, sigurimin e rregulloreve të drejta të tregut për subjektet mediale si dhe konsiderata për ngritjen profesionale të gazetarëve.¹³ Në bazë të ekspertizës dhe mendimit të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar nga fusha e mediave, këto organizata vlerësojnë gjendjen e përgjithshme të mediave në secilin shtet. Sa i përket Kosovës, këto raporte tregojnë se fusha mediale e Kosovës është ende e brishtë.




¹³ Për një metodologji të plotë të tre raporteve më kryesore për media ju lutem konsultoni metodologjinë e *Freedom of the Press* të Freedom House <http://bit.ly/HQqOU4>, metodologjinë e *Nations in Transit* të Freedom House <http://bit.ly/JuJ3p1>, metodologjinë e *Press Freedom Index* të Reporters Without Borders <http://bit.ly/xMMA7G>, si dhe metodologjinë e *Media Sustainability Index* të IREX <http://bit.ly/ab709T>

Komisioni Evropian (KE) publikon raporte vjetore që vlerësojnë përparimin e bërë nga shtetet e përfshira në agjendën për zgjerimin e BE-së drejtë hyrjes së tyre në Union.¹⁴ Raportet e progresit adresojnë edhe përmirësimet që i kanë bërë vendet në fushën e mediave, duke pasur parasysh lirinë e shprehjes, komunikimin elektronik, teknologjitë informative dhe politikat audio-vizuale.

Duke filluar nga viti 2005, indikatorët e raportit të progresit mbi fushën e mediave në Kosovë kanë treguar një mungesë të përgjithshme të arritjeve substanciale. Arsyet për mungesë të një përparimi të dukshëm sa i përket lirisë së shprehjes kanë qenë presioni i vazhdueshëm ndaj gazetarëve, mungesa e qasjes së duhur në dokumente publike si dhe problemet rreth kornizës ligjore dhe financimit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) si dhe kriminalizimi i shpifjes. Njëkohësisht, sektori i politikave audio-vizuale është dëmtuar nga çështjet që kanë të bëjnë me financimin jo të duhur të KPM-së dhe mangësive në zgjedhjen e anëtarëve të bordit të këtij Komisioni. Vërejtjet pozitive kishin të bëjnë kryesisht me zhvillimin e kornizës ligjore mbi mediat e lira, edhe pse pak vëmendje i është kushtuar zbatimit të legjislacionit të cekur.

Këto të gjetura përputhen me të gjeturat e një indeksi të spikatur ndërkombëtar për media, raportin e Freedom House, Nation in Transit.¹⁵ Ky raport, i cili e mbulon edhe Kosovën që nga viti 2002, përmban një vlerësim të indikatorëve të nivelit të demokratizimit në një vend.



¹⁴ Këto vende janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Islanda, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia

¹⁵ Freedom House boton edhe raportin global të quajtur Freedom of the Press ; megjithatë, të dhënat për Kosovë janë të disponueshme vetëm për vitin 2010 dhe 2011, që janë të dhëna të pakta për një analizë përmbajtjesore.


Ngjashëm me Raportet e Progresit të KE-së, mediat e pavarura luajnë një rol të rëndësishëm edhe për vlerësimet që jepen rreth ambientit demokratik në Kosovë. Arritjet e medias së pavarur janë të njëtrajtshme përgjatë viteve dhe i afrohen notës më të dobët të raportit Nations in Transit (NIT), notë kjo e ngjashme me ato të regjimeve gjysmë të konsoliduara autoritare. Nëse krahasohet me vendet e tjera, ky kategorizim mund të duket virtual dhe paksa i ekzagjeruar, mirëpo çështjet të cilat i konsideron Freedom House si indikatorë janë shumë reale.

Sipas raportit të NIT, gazetarët e Kosovës vazhdimisht ballafaqohen me presion të formës fizike, financiare ose redaktuese, i cili i shtyn ata drejt vetë-censurës. Për më tepër, raportet tregojnë se korniza ligjore, edhe pse shënon një përparim, ende paraqet pengesa për punën e gazetarëve. Këto çështje përkeqësohen edhe më shumë për shkak të mungesës së një tregu të qëndrueshëm medial dhe transmetuesit publik të ndikuar politikisht, gjë të cilën ata e shohin si një varësi të qëllimshme financiare në Buxhetin e Kosovës.

NIT ka vënë re edhe arritjet e bëra në fushën e mediave në Kosovë. Sipas raporteve, arritjet më të mëdha janë themelimi i KPM-së me një bord, i cili është konsideruar të jetë kryesisht i pavarur, themelimi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, përpjekjet për dekriminalizmin e shpifjes dhe përmirësimi i kornizës ligjore. Megjithatë, shumica e të gjeturave të NIT shfaqin një pamje të zymtë sa i përket kushteve të tanishme të mediave në Kosovë. Të gjeturat e reflektuara në këto raporte e vendosin Kosovën në një pozitë pak më poshtë se mesatarja e Ballkanit Perëndimor si dhe larg nga vendet e Bashkimit Evropian.

Reporters Without Borders - Press Freedom Index

Krahasim ndërmjet BE-së, Ballkanit Perëndimor dhe Kosovës




Në fakt, një trend i tillë behët evident kur analizohet Indeksi i Lirisë së Mediave i Reporterëve Pa Kufij (RWB). Të gjeturat e RWB, edhe pse mblidhen për tërë Ballkanin

Perëndimor në përgjithësi, reflektojnë të gjitha çështjet e Raporteve të Progresit të KE-së dhe ato të Nations in Transit. Këto çështje përfshijnë vetë-censurën e zbatuar nga gazetarët, mjetet financiare qeveritare për reklama që u jepen mediave të afërta me qeverinë, dhe moszbatimi i kornizave ligjore për media.¹⁶ Këto dy raporte ndërkombëtare plotësojnë njëra tjetrën sa i përket metodologjisë dhe sjellin pak a shumë të njëjtat te gjetura, që është një tregues i mirë sa i përket saktësisë së tyre.

Studimet përfundimtare që janë marrë parasysh sa i përket mediave në Kosovë janë ato të IREX. Kjo organizatë publikon analiza vjetore të cilat quhen Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave (MSI) dhe i mbledhë të dhënat e saj nga ekspertët vendorë. Rezultati i MSI për Kosovë dallon pak nga publikimet tjera sepse përfaqëson një analizë e cila fokusohet në funksionet e ndryshme të mediave. Prandaj, sipas asaj që shihet në tabelën e IREX – MSI më poshtë, të arriturat e Kosovës kanë dhënë shenja të përmirësimit gjatë viteve. Megjithatë, vlen të përmendet se rezultatet kanë shënuar rënie disa herë, ku vitet më të dobëta ishin 2003, 2005, 2008 dhe 2009.

IREX - Media Sustainability Index - Kosovë



MSI ka konsideruar se disa çështje kanë vazhduar përgjatë viteve, përfshirë këtu kriminalizmin e shpifjes, normat joadekuate për pavarësinë e transmetuesit publik, qasja e

¹⁶ Shpjegimi i tabelës së Reporters Without Borders: Të dhënat e krahasimit fillojnë në 2005 për shkak të mungesës së të dhënave për Kosovë për vite të mëhershme. Krahasimi ndërpritet në 2010 për shkak të implementimit të pikëve negative për shtete me performancë më të mirë. Kjo e pamundëson një krahasim mesatar domethënës të Ballkanit Perëndimor me vende të BE-së. Mesatarja e pikëve të BE-së nuk përfshin Luksemburgun dhe Maltën. Mesatarja e pikëve të Ballkanit Perëndimor nuk përfshin Kosovën.

kufizuar në informacione dhe mos-ndjekjen e krimeve kundër gazetarëve ose fjalës së lirë. Përmirësimet më të dukshme të vëna re nga MSI janë ato që kanë të bëjnë me dispozitat ligjore për mbrojtje e lirisë së shprehjes, rritjen e tregut për reklama, themelimin e shoqatave të pavarura si dhe nivelin shumë të kënaqshëm të pluralizmit medial.

Monitorimi ndërkombëtar i ambientit medial në Kosovë ka qenë i pasur gjatë 11 viteve të fundit. Gjatë kësaj kohe janë vërejtur një numër i përparimeve sa i përket kornizës për lirinë dhe qëndrueshmërinë e mediave. Fatkeqësisht, arritjet e tilla janë zbehur nga numri dhe impakti i vazhdueshëm i problemeve që kanë ndikim në mediat në Kosovë. Gazetarët vazhdojnë të jenë nën presion të dispozitave joadekuate ligjore të cilat janë menduar për t'i mbrojtur ata dhe për t'iu mundësuar atyre që të kryejnë detyrat e tyre.

Gazetarëve nuk iu ofrohet mbrojtje adekuate për konfidencialitetin e burimit të tyre dhe kërkohet nga ata që të zbulojnë burimin e tyre të informatës sipas kërkesës së dispozitave të diskutueshme të kodit penal. Në anën tjetër, presioni financiar mbi redaktorët dhe gazetarët është në përputhje me të hyrat e ulëta për subjektet mediale si dhe për vetë gazetarët. Kurse punëdhënësit nuk sigurojnë kontrata dhe beneficione të tjera të punës, gjë e cila e rritë pasigurinë e përgjithshme të gazetarëve. Tërë këto konsiderata i shtohen trendit të vazhdueshëm të ndikimit dhe presionit politik, e cila është përmendur në të gjithë indikatorët kryesor ndërkombëtarë të mediave sa i përket Kosovës.

Njëkohësisht, alternativat për ngritje profesionale të gazetarëve janë mjaftë të rralla, dhe mund të konsiderohet se janë gati jo-ekzistente. Shumica e trajnimeve kryhen në vend të punës kurse niveli i zëvendësimit të gazetarëve në media është i lartë, gjë e cila e bënë profesionalizimin e programeve trajnuese në media joprofitabile. Vetë media luftojnë për të siguruar të ardhura e nevojshme, sidomos duke pasur parasysh faktin se institucionet e Kosovës mbesin kontraktuesi më i madh në vend. Ky dhe faktorët e tjerë ekonomik dhe politik i kontribuojnë mungesës së përgjithshme të përmirësimit në sektorin e mediave. Si rezultat i kësaj, gjetja e një zgjidhjeje për këto sfida të vazhdueshme është vendimtare për t'u siguruar që subjektet mediale dhe gazetarët në Kosovë do të kalojnë pengesat përfundimtare për të arritur qëndrueshmëri, pavarësi dhe kualitet.

6. SFIDAT E VAZHUESHME

Sipas vëzhguesve ndërkombëtarë dhe vendor të lirisë së fjalës dhe sektorit medial në përgjithësi në Kosovë, ekzistojnë disa çështje që duhet të adresohen në nivelin politik nga pjesëmarrësit institucional dhe jo-qeveritarë. Ato do të analizohen në mënyrë të detajuar më poshtë.

6.1 Presioni mbi gazetarë

Gazetarët në Kosovë ballafaqohen me një presion të vazhdueshëm, ku shkalla e konfrontimit të drejtpërdrejtë është e lartë, sidomos për një vend që ka më pak se dy milion banorë. Në vitin 2011, Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK) ka bërë 27 ankesa publike rreth cenimit të drejtave dhe sigurisë së gazetarëve.¹⁷ Nëntë nga këto raste ishin sulme fizike, shtatë ishin kërcënime, kurse të tjerat ishin ofendime publike, dëmtim i pronës dhe forma të tjera të dhunës. Sipas AGPK, ky nuk është numri i përgjithshëm i sulmeve ndaj gazetarëve, sepse AGPK është dashur të mbajë disa raste sekret për shkak të kërkesës së viktimave. Ky numër i cenimeve është tejet brengosës, sidomos duke pasur parasysh faktin se kjo po ndodh 12 vite pasi që Kosova ka filluar të ndërtojë institucione demokratike.

Një nga arsyet e cituara shpesh për numrin e lartë të numrit të presioneve ndaj gazetarëve, së paku kur presioni bëhet nga zyrtarët publik, është mungesa e trajnimeve dhe e përgatitjes së këtyre zyrtarëve lidhur me komunikimin me gazetarë. Nuk ka ndonjë modul zyrtar në institucionet e Kosovës për trajnim se si duhet të sillen me gazetarë. Megjithatë, një rast specifik i dhunës mund të rrëzojë një pjesë të këtij nocioni, pasi që zyrtari për shtyp i Kuvendit të Kosovës ka sulmuar fizikisht një reportere derisa ajo po fotografonte Presidenten e porsa-emëruar të Kosovës.¹⁸ Gjithashtu, ka pasur kërcënime dhe ushtrime të tjera të dhunës nga ana e zyrtarëve shtetëror dhe komunal.

Ky trend i vazhdueshëm i dhunës dhe formave të tjera të presionit ndaj gazetarëve ndodh kryesisht për shkak se krimet kundër gazetarëve nuk ndiqen në mënyrën e duhur, gjë që krijon një perceptim se gazetarët janë caqe të lehta për dhunë. Sistemi ligjor i Kosovës është i mbingarkuar, me një numër të lartë të lëndëve nga vitet e kaluara dhe me kapacitete të pakta për menaxhimin e të gjitha rasteve të reja në mënyrë efikase.¹⁹ Korrupsioni i gjyqësorit dhe presionit politik mbi gjyqësorin e bëjnë këtë dukuri edhe më të rëndë.²⁰ Për më tepër, vetëm disa raste të kërcënimit dhe dhunës kundër gazetarëve arrijnë deri tek prokurorët dhe policia, të cilët kanë problemet e njëjta si ato të gjyqësorit. Përfundimisht, mungesa e transparencës

¹⁷ Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, Statistika të Ndërhyrjes në Punën e Gazetarëve (2011)

¹⁸ AGPK dënon sulmin ndaj fotoreporteres së Zërit (7 Prill 2011), Telegrafi. E marrë nga: <http://bit.ly/13hErh>

¹⁹ European Commission, Kosovo Progress Report (2010), f.11

²⁰ Ibid

së gjyqësorit dhe prokurorisë ua pamundëson vëzhguesve të pavarur, siç janë AGPK-ja, që të monitorojnë dhe avokojnë në mënyrë të duhur për zgjidhjen e shpejtë të këtyre rasteve. Si rezultat i kësaj, edhe gjyqësori edhe prokuroria janë subjekt i lehtë i presionin për të mos ndjekur raste të dhunës kundër gazetarëve si dhe lënien e këtyre rasteve anash, thjeshtë duke e minimizuar rëndësinë e tyre. Fakti se gjyqet janë të mbingarkuara me raste voluminoze nga e kaluara ka gjithashtu ndikim edhe në mungesën e efikasitetit të tyre.

Problemet e cekura më lartë nuk ndihmohen nga mungesa e mbrojtjes së duhur ligjore për gazetarët në punën e tyre të përditshme. Me 20 prill, 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi me 86 vota Kodin e ri Penal. Ky Kod përmban një dispozitë të pjesshme e cila nuk parasheh aktakuza penale kundër gazetarëve të cilët mbrojnë burimet e tyre. Megjithatë, disa kufizime janë vendosur mbi këtë dispozitë, që lënë mjaft hapësirë për interpretim të rasteve kur gazetarët do të duhet të zbulojnë burimin e tyre.²¹ Kjo praktikë ushtron një presion të lartë mbi gazetarë kur ata ndjekin burimet për ngjarjet shumë kontroverse, gjë e cila e dëmton seriozisht mundësinë e gazetarëve për të kryer punën e tyre në mënyrën e duhur.

Ky presion ambiental vjen edhe nga vetë mediat për shkak të çështjeve administrative me punëdhënësit. Shumicës së subjekteve mediale u mungojnë marrëdhëniet e duhura kontraktuale me gazetarët dhe redaktorët e tyre, fakt i cili nuk përbën gati kurrfarë sigurie të punësimit. Për më tepër, pagat për gazetarë, edhe pse janë pakëz më të larta se ato të nivelit kombëtar, ende konsiderohen se nuk janë adekuate për të siguruar një stabilitet të duhur financiar.²² Njëkohësisht, gazetarëve nuk u ofrohen përfitimet e tjera, siç janë sigurimi shëndetësor ose mbrojtja ligjore në rast të ngritjes së akuzave kundër tyre.

Në krye të të gjitha çështjeve specifike të Kosovës është fakti se edhe gazetarët e Kosovës ballafaqohen me sfidat globale me të cilat përballen mediat. Depërtimi i pavarësisë redaktuese përballë reklamuesve, presionit politik përmes lidhjeve të ngushta në mes të pronarëve të mediave dhe politikanëve si dhe rënia globale e të hyrave të mediave, sidomos të mediave të shkruara, janë vetëm disa nga brengat. Si rezultat i kësaj, gazetarët në Kosovë shpesh zgjedhin vetë-censurën me qëllim që të ruajnë sigurinë e tyre financiare. Kjo vetë-censurë i kontribuon një mase të dukshme të gazetarisë protokollare në fushën e mediave në Kosovë, pasi që mbulimi i ngjarjeve dhe takimeve protokollare nuk kërkon punë të diskutueshme dhe hulumtuese. Megjithatë, një pjesë e subjekteve kryesore mediale dhe e reporterëve vazhdojnë të bëjnë punë kualitative, hulumtuese, dhe analitike, gjë e cila tregon një elasticitet të përgjithshëm të industrisë së mediave dhe një nivel të qëndrueshmërisë profesionale të redaktorëve dhe gazetarëve.

²¹ Kuvendi i Kosovës, Drafti i Kodit Penal (23 prill 2012) Neni 38, paragrafi 2.

²² IREX, Media Sustainability Index Europe & Eurasia (2011), p.66

6.2 Qasja në informata

Një nga sfidat kryesore të identifikuar në raportet e hershme ndërkombëtare lidhur me lirinë e mediave në Kosovë, por edhe sipas mendimit të vendorëve, është çështja e qasjes në dokumente publike. Deri në vitin 2006, Kosova nuk ka pasur një kornizë të tillë ligjore, gjë e cila ua ka pamundësuar gazetarëve që dokumentet publike t'i marrin në mënyrë ligjore dhe pa rrjedhje të informatave. Pas shumë përpjekjeve vendore për avokim, institucionet e Kosovës hartuan dhe miratuan ligjin për Qasje në Dokumente Publike, i cili u miratua nga PSSP-ja, dhe, në esencë ishte një akt për lirinë e informatës. Edhe pse u prit mirë, miratimi i ligjit solli një përmirësim të diskutueshëm sa i përket çështjes së përgjithshme të qasjes në informata. Arsyeja pse nuk kishte ende nuk ka përmirësime lidhet kryesisht me zyrtarët publik dhe ndërhyrjet politike.²³

Në fillim, për shkak të mungesës së një kornize ligjore e cila do të klasifikonte konfidencialitetin e dokumenteve, zyrtarët publik refuzonin qasjen në informacione bazuar në sekretin institucional në një formë apo tjetrën. Ky arsyetim u kufizua në masë të madhe pas miratimit të Ligjit mbi Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimit të Sigurisë në qershor 2010. Megjithatë, zbatimi i ligjit mbeti i kufizuar, ku raportet ndërkombëtare dhe vendore e identifikuan këtë çështje si një fushë problematike. Për më tepër, ligji nuk është duke u zbatuar plotësisht edhe për shkak se nuk është emëruar stafi përgjegjës për procedimin e kërkesave.

Mungesa e vullnetit politik është arsyeja kryesore se pse ky ligj nuk po zbatohet në mënyrë të duhur.²⁴ Redaktorët dhe analistët theksojnë se qasja në informacione është duke u përdorur si një mjet politik për të ndalur mediat të cilat kritikojnë qeverinë dhe për të shpërblyer subjektet mediale që kanë një reflektim pozitiv.²⁵ Kjo praktikë a e dëmton gazetarinë në përgjithësi në Kosovë dhe e kufizon në mënyrë të drejtpërdrejtë numrin e ngjarjeve të cilat mund t'i ndjekin gazetarët. Megjithatë, kjo ka edhe një efekt qëllimkeq sepse i detyron gazetarët që të bazohen në informata të paverifikuara, burime me qëllime të diskutueshme dhe lidhje personale kur atyre u duhet të marrin një informatë.

Varësia e tillë shpien drejtë një vargu të sfidave serioze dhe rreziqeve për subjektet mediale, redaktorët, dhe gazetarët. Përdorimi i dokumenteve të paverifikuara i vë subjektet para rrezikut të panevojshëm të publikimit të informative të pasakta, raste të cilat e dëmtojnë rëndë reputacionin e tij. Kjo gjithashtu iu jep një mundësi palëve, të cilat kanë për qëllim që të diskreditojnë një subjekt ose reporter, që të krijojnë dokumente false – që janë një mjet i fuqishëm sabotues me pasoja të frikshme. Njëkohësisht, për shkak të varësisë nga sigurimi i

²³ Intervistë e INDEP me Astrit Gashi, Kryeredaktor, Zëri. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012

²⁴ Ibid

²⁵ Ibid. Intervistë e INDEP me Faik Ispahiu, Drejtor Ekzekutiv, Internews Kosova. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012

dokumenteve publike, mediat bëhen të cenushme nga palët të cilat mund t'iu japin dokumentet mirëpo kanë agjenda potencialisht dëmtuese. Kjo i bënë mediat bartës të pavullnetshëm të agjendave të tilla, gjë e cila e rrezikon edhe më shumë imazhin dhe pavarësinë e tyre. Përfundimisht, gazetarët që mbulojnë institucionet publike vihen në një pozitë të keqe dhe duhet të bëjnë llogari mirë rreth ngjarjeve të cilat i ndjekin me qëllim që mos të humbin burimin, i cili nuk do të ishte i nevojshëm në një rast tjetër.²⁶ Në anën tjetër, institucionet qeverisëse, siç janë ministrinë, praktikojnë politika selektive ndaj subjekteve të cilave u japin intervista dhe informata, praktikë e cila nuk është krejt kundërthënëse.

Megjithatë, problemi qëndron në faktin se rritja e ndikimit mbi stafin civil do të thotë se e tërë ministria mund të mbyllet ndaj subjekteve mediale, gjë e cila krijon çështje lidhur me transparencën dhe i shkakton edhe më shumë dëme qasjes në informata. Për më tepër, Qeveria e Kosovës ende nuk ka emëruar një zëdhënës, mos emërim i cili i vështirëson në mënyrë të panevojshme disa çështje të vogla, siç janë sigurimi i një citati për ndonjë çështje të caktuar, dhe i ngarkon zyrtarët e lartë publik me detyra të tilla.

Sfidat me të cilat ballafaqohen gazetarët dhe subjektet mediale sa i përket edhe çështjeve më të imta për qasje në informata janë pengesa të konsiderueshme për sigurimin e plotë të lirisë së mediave në Kosovë. Pa dyshim, kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në numrin e çështjeve të cilat mbulohen nga mediat, kualitetin e mbulimit, pavarësinë dhe saktësinë e raportimit. Kjo praktikë i shtohet edhe presionit të cilin tanimë janë duke e përjetuar gazetarët, gjë e cila e bënë punën e tyre edhe më të vështirë. Prandaj, zgjidhja e problemit rreth qasjes në dokumente publike është shumë e rëndësishme për të siguruar se mediat janë duke e luajtur rolin e tyre vëzhgues me saktësi dhe çështjet shoqërore po adresohen në mënyrën e duhur.

6.3 Gazetaria profesionale dhe menaxhimi

Kosova e pas luftës ka qenë dëshmitare e shpërthimit të një numri të mundësive për arsimim të lartë në sektorin publik edhe atë privat. Këto institucione ofrojnë drejtimet më të kërkuara për arsimim, siç janë Drejtësia, Administrimi i Biznesit, Ekonomia, etj. Megjithatë, vetëm pak përpjekje të kufizuara janë bërë sa i përket zhvillimit të programeve për gazetari, dhe shumica e tyre kanë pasur sukses të kufizuar dhe kualitet të diskutueshëm. E njëjta situatë është edhe sa i përket trajnimeve të përkohshme, kurse përveç një programi relativisht të ri në një universitet privat, tani për tani nuk ekziston ndonjë program arsimor tërë-jetësorë për profesionistët që punojnë.

²⁶Intervistë e INDEP me Astrit Gashi, Kryeredaktor, Zëri. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012

Kolegji Faik Konica është institucioni i parë privat që u mundua të adresojë dëshirën e studentëve që duan të studiojnë gazetarinë në Kosovë. Ky institucion akademik ofroi vetëm arsim gazetaresk, mirëpo, ai u ballafaqua me disa sfida sa i përket akreditimit vendor. Në vitin 2006, Universiteti i Prishtinës, që sponsorizohet nga shteti, filloi të ofrojë një program për gazetari në Fakultetin Filologjik. Kualiteti i përgjithshëm i këtij Fakulteti është mjaft i dobët dhe ekziston rreziku që ky Fakultet të shndërrohet si një mundësi e dytë për studentët të cilët nuk janë të suksesshëm në fushat e tjera por që insistojnë të studiojnë.

Instituti Kosovar për Gazetari dhe Komunikim (KIJAC) ishte një institucion që ishte mirëpritur por pati jetë të shkurtër. Ai ofroi studime post-diplomike dhe mëtoi që t'iu ofrojë profesionistëve rajonal të gazetarisë arsimim të klasit botërorë. Ky program, i cili financohej tërësisht nga Ministria e Jashtme Norvegjeze, pati mbështetje akademike nga katër universitete botërore, përfshirë edhe Universitetin e Kardifit dhe Universitetin e Nebraska Linkoln. Pesë gjenerata të studentëve, të cilët diplomuan në këtë program dhe morën diplomat Master për gazetari dhe komunikim, mbajnë pozita kyçe në subjektet mediale në Kosovë. Megjithatë, për shkak të keq-menaxhimit të programit dhe fondeve të tij, KIJAC u mbyll në vitin 2010 dhe asnjë nga diplomat e tij nuk u akredituan.

Të vetmet programe universitare të gazetarisë që kanë mbijetuar ende janë departamenti për Komunikim Masiv në Universitetin Privat AAB dhe ai në Universitetin e Prishtinës. Megjithatë, sipas mendimit të redaktorëve dhe analistëve të mediave, kualiteti i këtyre programeve është i diskutueshëm²⁷, kurse shumica e trajnimeve për gazetarë kryhen nga vetë mediat në vend të punës.²⁸ Kjo praktikë i mbingarkon mediat, veçanërisht duke pasur parasysh se në shkallën botërore ka një mbingarkesë të profesionistëve medial të përgatitur mirë.

Mungesa e programeve kualitative akademike e kufizon gatishmërinë e subjekteve mediale që të sponsorizojnë përgatitjen profesionale të gazetarëve të tyre, pasi që mendohet se kthimi i investimit është i ultë. Për më tepër, pasi që organizatat ndërkombëtare në Kosovë ofrojnë paga më të larta dhe siguri më të lartë për punë, subjektet mediale në Kosovë humbin shumë punëtorë, gjë e cila e vështirëson kthimin afat-gjatë të investimit në arsimimin e gazetarëve. Këto dy probleme janë përkeqësuar edhe më tepër për shkak të mungesës së rritjes ekonomike, e cila ndikon në mënyrë të konsiderueshme në të hyrat e subjekteve mediale si dhe mundësitë e tyre që të zotojnë burime për zhvillim profesional nga jashtë.

Situata e pasigurt e programeve akademike për gazetari nuk ndihmohet as nga sigurimi i ulët i moduleve trajnuese për gazetarë. Derisa gjatë viteve të para pas luftës dhe themelimit të

²⁷ IREX, Media Sustainability Index Europe & Eurasia (2010), f.64

²⁸ Intervistë e INDEP me Faik Ispahiu, Drejtor Ekzekutiv, Internews Kosova, Astit Gashi, Kryeredaktor, Zëri. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012

administratës ndërkombëtare në Kosovë, mbështetja e donatorëve për trajnimin e gazetarëve ishte e lartë, kjo ndihmë tani është kufizuar mjaftë shumë. Si rezultat i kësaj, përkundër faktit se kërkesa është e lartë, rrallë ofrohen kurse dhe shumica e tyre janë joformale dhe ofrohen nga trajnerë jo-profesionist.²⁹ Kjo çështje ka ndikim të madh në gazetarinë hulumtuese, pasi që ky lloj i gazetarisë kërkon një nivel të lartë të hulumtimit dhe përgatitjes për të kryer këtë detyrë në mënyrë të duhur.

Prandaj, përkundër përmirësimeve të konsiderueshme që janë bërë gjatë viteve të fundit, gazetaria hulumtuese është ende në një gjendje brengosëse të pazhvilluar. Për shkak të mungesës së trajnimeve të duhura, shpesh ndodhë që redaktorët dhe gazetarët keqkuptojnë konceptin e gazetarisë hulumtuese lidhur me botimin e dokumenteve të rrjedhura dhe/ose intervistave ekskluzive. Prandaj, disa subjekte mendojnë se puna hulumtuese kryhet përmes një burimi të vetëm, që shpesh është anonim e me karakter sensational.³⁰ Gjendja e brishtë e gazetarisë hulumtuese ndikohet edhe nga trendët e përmendura më lartë për shkak të mungesës së qasjes në informata dhe pengesave të tjera kundrejt profesionit të gazetarisë.

Sa i përket aspektit menaxherial, mediat në Kosovë janë në një udhëkryq, ku të hyrat nga reklamat dhe mundësitë për reklama janë rritur dukshëm nga viti 2000, mirëpo vendimarrja e bazuar në hulumtimin e tregut është ende e ultë. Çështja e hulumtimit të tregut lidhet pjesërisht edhe me paaftësinë e agjencive reklamuese për të siguruar të dhëna që janë të bazuara në interesin e klientëve të tyre. Pa dyshim, kjo ndodhë edhe për shkak të tregut të vogël në përgjithësi, i cili ka më pak se dy milion banorë, dhe për shkak të ambientit të vështirë ekonomik. Njëkohësisht, edhe vetë mediat, si ato transmetuese por edhe ato të shkruarat, rrallë bëjnë hulumtimin e tregut lidhur me lexueshmërinë apo shikueshmërinë së tyre, proces i cili do t'i vendoste në një pozitë më të mirë ndaj reklamuesve të specializuar.

Çështja e hulumtimit të tregut është akut sidomos sa i përket mediave të shkruara, kanalet shpërndarëse të cilave janë në masë të madhe të paqarta dhe jo-plurale. Statistikat për qarkullimin e tyre vështirë mund të gjenden për shkak të qëllimit për mbizotërim në shpërndarjen e mediave të shkruara. Për më tepër, për shkak të ekonomisë së dobët, mediat e shkruara nuk mund të bazohen në shërbimet me parapagim për shkak se profiti i perceptuar do të tejkalojë shpenzimet. Prandaj, kjo ka çuar drejtë stagnimit të zhvillimit të raportimit për audiencën të specializuara siç është mediave të shkruara, dhe ka rritur varësinë e tyre në burime potencialisht komprometuese të financimit, siç janë subvencionet ndër-biznesore.

Varësia nga metodat e këtilla të sigurimit të të hyrave është përkeqësuar pas vendimit të Qeverisë për të hequr tërësisht buxhetin e saj për reklama publike.³¹ Përkundër deklaratave të

²⁹ IREX, Media Sustainability Index Europe & Eurasia (2011), p.70

³⁰ Intervista të INDEP me ekspertë të mediave nga Kosova dhe rajoni, janar – prill 2012

³¹ INDEP intervistë me Astit Gashi, Kryeredaktor, Zëri. Prishtinë, Kosovë, Prill 2012

shumta se reklamat e Qeverisë ishin përdorur në masë të madhe si një metodë për shpërblim ose dënim politik të mediave³², realiteti tregon se Qeveria është kontraktuesi më i madh në vend. Megjithatë, me qëllim që të lehtësohen disa nga ngarkesa financiare që u paraqiten pas vendimit të qeverisë, është paraparë heqja e taksës për vlerën e shtuar për mediat e shkruara.

6.4 Radio Televizioni i Kosovës

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) është themeluar menjëherë pas luftës, duke e vendosur infrastrukturën e tij në Radio Televizionin e vjetër të Prishtinës. Si transmetues publik, qëllimi parësor i RTK-së është të sigurojë një program të avancuar informativ dhe arsimor, kulturalisht të shumëllojshëm, dhe argëtues. Këto qëllime janë të ngjashme me qëllimet e transmetuesve kryesor publik në botë, të cilët i shërbejnë interesit të publikut.

Në fillim, Radio Televizioni i Kosovës është financuar përmes një kontrate me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), e cila mblydhte një taksë prej 3.5 euro nga të gjithë konsumatorët e saj përmes faturave të rrymës. Kjo kontratë, e cila ishte nënshkruar në vitin 2005, ishte paraparë për tri vite, deri në nëntor 2009.³³ Për shërbimin e ofruar, KEK-ut i paguheshin 6% provizion dhe ishte ofruar mundësi për disa reklama pa pagesë. Pas shpalljes së pavarësisë të Kosovës, KEK-u refuzoi që të vazhdojë ofrimin e këtij shërbimi, duke thënë se kjo taksë po i dëmtonte të hyrat e saj.

Kontrata në mes të KEK-ut dhe RTK-së përfundoi në nëntor të vitit 2009 dhe e la financimin e RTK-së të bëhet përmes Buxhetit të Kosovës – buxhet ky i cili u hartua nga Ministria e Financave dhe u miratua nga Kuvendi i Kosovës. Kjo kontratë u ndërpre pjesërisht edhe për shkak të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila suspendoi përkohësisht zbatimin e Nenit 21 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës³⁴ dhe e këshilloi Kuvendin e Kosovës të shqyrtojë këtë ligj.³⁵ Në janar të vitit 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi një buxhet të përkohshëm gjashtë-mujor për RTK-në, i cili u morr nga Buxheti i Kosovës për vitin 2010.³⁶ Me këtë vendim, Kuvendi kërkoi edhe një rishikim profesional të RTK-së si dhe një auditim të pavarur.

Ekzistonin disa çështje lidhur me këto zhvillime, disa nga të cilat dolën nga mundësia e re që transmetuesi publik të ndikohet nga presioni i mundshëm financiar. Pasi që ishte vënë në një buxhet gjashtë-mujor, RTK-ja ishte vazhdimisht nën vrotimin e Kuvendit dhe Ministrisë së Financave. Kjo varësi ngriti shumë dyshime të monitoruesve vendorë dhe ndërkombëtarë

³² Gashi, K. "Tirazhi dhe Politizimi i Mediave të Shkruara në Kosovë", Prishtinë, Kosovë, OSCE – KIPRED, 2009. f.11

³³ Instituti për Studime të Avansuara (GAP), Qëndrueshmëria Financiare e RTK-së (2011), p.5

³⁴ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Tomë Krasniqi vs RTK et AL, KI 11/09 (2009)

³⁵ Ibid

³⁶ Transkripti i Seancës Plenare të Kuvendit të Kosovës, (28 – 29 janar 2010), f.45-46

rreth ndikimit që praktikat e tilla kanë pasur në pavarësinë e transmetuesit.³⁷ Për më tepër, Ligji mbi RTK-në, sidomos neni për financimin e televizionit, ishte nën shqyrtim, që do të thotë se nuk kishte një metodë të konsoliduar të financimit për transmetuesin.

Zgjidhja e çështjes së sponsorizimit të RTK-së erdhi dy vite më vonë, në mars të vitit 2012, kur ligji u votua në Kuvendin e Kosovës pas një vargu të polemikave. Drafti i parë i ligjit mbi RTK ka paraparë se ky transmetues do të financohet pjesërisht nga Buxheti i Kosovës, respektivisht me 0.7% të buxhetit të përgjithshëm për një periudhë tri-vjeçare. Kjo normë do të jetë valide për tri vite, gjatë të cilave transmetuesi duhet të vendosë për shumën e taksës si dhe të gjejë bartësin që do mbledhë taksën nga qytetarët e Kosovës. Për ironi, kjo periudhë përputhet me mandatin e qeverisë së tanishme, që do të thotë se zgjidhja e re duhet të gjendet në kohën e zgjedhjeve të ardhshme, gjë e cila paraqet rrezik në vetvete.

Të gjitha këto që u thanë rreth transmetuesit publik shpërfaqin dy çështje kryesore. Së pari, rrethanat që lidhen me përfundimin e financimit të RTK-së si dhe mungesa e vullnetit politik për të gjetur një metodë të shpejtë, të qëndrueshme dhe të pavarur për financim për këtë transmetues ngrenë pyetje rreth interesave potenciale për ndikim në këtë transmetues. Vonesat e panevojshme dhe kundërrhënëse mbështesin edhe më shumë dilemat rreth miratimit të ligjit të ri për transmetuesin publik, edhe pse ekziston një mendim i gjerë se ligji i ri është adekuat. Këto brenga mbështetën edhe më shumë për shkak të vonesave në përzgjedhjen e bordit të KPM, gjë e cila e vonoi edhe përzgjedhjen e trupave udhëheqës të RTK-së.

Përderisa dëshmitë, të cilat do të implikonin ndikimin politik në transmetuesin publik përmes perspektivës ligjorë, varen nga rrethanat, niveli i rastësisë dhe mungesa e përgjithshme e efikasitetit në miratimin e ligjit kanë qenë të shumta për t'u injoruar. Megjithatë, ligji i ri për RTK-në është përshëndetur në masë të madhe nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Tani për tani, sfida më qenësore për transmetuesin publik është krijimi i një politike të parapagimit dhe vetë-qëndrueshmërisë sa më shpejtë që është e mundur. Mbetet të shihet se sa mirë do të zbatohet ligji dhe sa mirë do të punojë RTK tani kur ajo ka përfundimisht një formë të stabilitetit financiar.

7. PËRFUNDIME

Kosova ka shënuar një numër të përmirësimeve të provizioneve ligjore sa i përket sektorit të medieve nëpërmjet ligjit për qasje në informata publike, dekriminalizimit të shpifjes dhe përmirësimit të kodit penal dhe ligjit rreth RTK-së. Sidoqoftë, akoma shumë punë mbetet

³⁷ Transkripti i Seancës Plenare të Kuvendit të Kosovës, (28 – 29 janar 2010), f.45-46

për tu bërë për implementimin adekuat të legjislacionit aktual dhe një mekanizëm për monitorimin e implementimit është i nevojshëm.

Një monitorim i tillë është veçanërisht i rëndësishëm për Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, për shkak se mos implementimi adekuat po e limiton aftësinë e gazetarëve për dokumentuar storjet me fakte duke i bërë të ndikueshëm nga burime të paverifikuara dhe presione të tjera. Përveç presionit profesional, gazetarët akoma janë subjekt i sulmeve fizike, kërcënimeve e formave më të fshehura të presionit si mungesa e stabilitetit financiar, mungesa e kontratave të duhura dhe një gjyqësor jo efikas i cili nuk mund t'i mbroj të drejtat e tyre në mënyrë adekuate.

Për shkak të kushteve të dobëta ekonomike në vend dhe impaktit ndaj medieve, zhvillimi profesional jashtë punës mund të jetë i papërballueshëm dhe jo kualitativ. Ndërkohë që disa programe të nivelit universitar janë duke u munduar të konsolidohen, ato akoma janë në filizat e tyre. Në ndërkohë, programe jo akademike të përgatitjes për gazetarë janë të pakta dhe shpesh të përgatitura nga trajnues jo profesional.

Çështjet e lartpërmendura përkeqësohen nga një transmetues i brishtë publik i cili në raste të tjera do të duhej të shërbente si një udhërrëfyes i standardeve profesionale për të gjitha mediat. RTK ka humbur një pjesë të besueshmërinë të tij, kryesisht për shkak të problemit rreth financimit i cili e bën subjekt të mundshëm të presionit politik apo tjetër. Megjithatë, për shkak se problemi i financimit të RTK-së mendohet se është zgjidhur me ligjin e ri, mbetet të shihet se si do të performojë transmetuesi publik në të ardhmen.

Mediat në Kosovë ballafaqohen me një probleme të dyanshme, specifike për Kosovën dhe ato të cilat ndikojnë mediat globale, veçanërisht mediat e shkruara. Me disa përmirësime të kornizës ligjore dhe një trend të dobët por që po përmirësohet të ndikimit të medieve në sektorin e politikave, këto sfida mund të tejkalohen. Sidoqoftë, më shumë punë duhet të bëhet për të siguruar që një nga kërkesat kryesore për vendosjen e demokracisë të përmbushet, gjegjësisht të siguruarit që mediat e lira janë të mbrojtura dhe të respektuara në Kosovë.

8. REKOMANDIME

1. Zyra e Kryeministrit të Kosovës duhet të krijojë një mekanizëm apo entitet që do të ketë për detyrë të sigurojë që Ligji për Qasje në Dokumente Publike po implementohet në mënyrë adekuate nëpër të gjitha institucionet vendore.

2. Mekanizmi / trupi i lartpërmendur gjithashtu duhet të monitorojë zyrat apo zyrtarët përgjegjës për përpunimin e kërkesave dhe duhet të implementojë ndëshkime në raste të mungesës së performancës sipas nevojës.
3. Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës duhet të draftojë një manual i cili shtjellon se si duhet komunikuar me gazetarë dhe si duhet trajtuar çështjet e dhunës ndaj gazetarëve.
4. Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të draftojë dhe të sigurojë implementimin e një politike që shpjegon metodat e trajtimit të rasteve të dhunës kundër gazetarëve. Kjo politikë gjithashtu duhet të shërbejë për t'u siguruar që prokurorët e kuptojnë rëndësinë që ka mbrojtja adekuate e gazetarëve.
5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të sigurohet që rasteve të dhunës ndaj gazetarëve u jepet prioriteti i nevojshëm dhe që këto raste të zgjidhen shpejtë dhe në mënyrë transparente.
6. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të kërkojë implementimin e Ligjit të Punës nga operatorët media në Kosovë, veçanërisht për të siguruar kushte adekuate të punës për gazetarë.
7. Pronarët e mediave duhet të konsiderojnë zhvillimin dhe implementimin e mundësive për avancim profesional të gazetarëve të tyre më të mirë, qoftë brenda kompanisë ose jashtë. Këto programe mund të zhvillohen në bashkëpunim me institucione akademike, media ndërkombëtare dhe organizata që mbështesin punën e mediave.
8. Radio Televizioni i Kosovës duhet të stimulojë mbikëqyrjen e pavarur të programit të saj si dhe monitorimin e stacioneve radio televizive. Ky stimulim mund të bëhet qoftë nëpërmjet kërkesave direkte për monitorim apo rritjes së transparencës dhe qasjes ndaj këtij institucioni.
9. Bordi i Radio Televizionit të Kosovës duhet të draftojë sa më shpejtë të jetë e mundur një strategji profesionale dhe financiare në mënyrë që të sigurojë pavarësinë e plotë të RTK-së. RTK inkurajohet që të kërkojë ndihmë nga organizata mbështetëse që punojnë në fushën e mediave.
10. Pronarët dhe redaktorët media duhet të zhvillojnë raportimin mbi fusha specifike në mediat e tyre dhe ta përdorin si një mënyrë për të tërhequr lexues, shikues dhe reklamues të specializuar.

ISBN 978-9951-627-00-9



9 789951 627009

INDEP 2012